Konfirmohet
Enkelejda Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 5754 Prot.

Lushnjë më, 16/06/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT:

"SISTEMIM ASFALTIM I RRUGËVE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE ALLKAJ,FIERSHEGAN,BALLAGAT,KRUTJE,DUSHK,KARBUNARË"

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë

"Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, parashikohen ndërhyrje për sistemimin dhe asfaltimin e segmenteve rrugore në njësitë administrative dhe fshatrat përkatëse, si më poshtë:"

Njësia Administrative Allkaj

- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Argjinaturës", fshati Zhelizhan, L = 610 ml.

Njësia Administrative Fiershegan

- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Degëzimet", fshati Kosovë e Vogël, L = 1,266 ml.
- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Skraparllinjve", fshati Kosovë e Vogël, L = 1,560 ml.

Njësia Administrative Ballagat

- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Kuqëve", fshati Jasëxhias, L = 876 ml.
- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Dajallarëve", fshati Jasëxhias, L = 390 ml.
- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Mullalinjëve", fshati Jasëxhias, L = 350 ml.

Njësia Administrative Krutje

- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Trokallarëve", fshati Ngurrëz e Vogël, L = 375 ml.
- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Faslli Veliu", fshati Ngurrëz e Vogël, L = 550 ml.

Njësia Administrative Dushk

- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Ambulancës", fshati Dushk, L = 255 ml.
- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Mirësia", fshati Dushk, L = 725 ml.
- Sistemim-Asfaltim i rrugës "Sharkenjve", fshati Dushk, L = 360 ml.

Njësia Administrative Karbunarë

- Sistemim-Asfaltim i rrugëve në fshatin Balaj, L = 1355 ml.

Disa Segmente rrugore të përfshira në projekt paraqiten në gjendje të amortizuar si pasojë e mungesës së investimeve ndër vite , ndërsa disa të tjera (degëzimet ne fshatin Kosovë e vogël) janë kryer ndërhyrje në mbushje me material shkëmbor të rrugës ndaj edhe po kryhet asfaltimi i tyre. Trupi rrugor karakterizohet nga deformime përgjatë gjithë gjatësisë me gropa, ulje lokale, çarje sipërfaqësore, konsumim i shtresave ekzistuese si dhe mungesë e sistemit funksional të largimit të ujërave sipërfaqësore.
Ndërhyrja konsiston në nivelimin e trupit të rrugës, mbushjen me çakëll e gur gurore , shtresë stabilizanti , shtresat asfaltike (Binder+ Asfalt).
Gjithashtu segmentet rrugore do shoqërohen me sinjalistikë vertikale dhe horizontale (Vijëzim rrugor dhe tabela). Një gjatësi prej 95ml (degëzimet) do të trajtohen me mbushje me beton.
Realizimi i këtij investimi do t'u sigurojë banorëve që kanë banesat përgjatë këtyre segmenteve rrugore akses të sigurt, kushte të përshtatshme infrastrukturore, duke përmirësuar ndjeshëm lëvizshmërinë, lidhjen me rrjetin kryesor rrugor dhe shërbimet publike.
Kjo ndërhyrje parashikon asfaltimin e një sipërfaqeje totale prej 40218 m² rrugë, me qëllim përmirësimin e aksesit dhe rritjen e sigurisë në qarkullim.

Ndërhyrja është dhe si kërkesë e qytetarëve të lushnjës në dëgjesat e buxhetit të vitit 2026 të zhvilluara gjatë muajit nëntor 2025.

Kjo ndërhyrje me vlerë 170,710,340.28 lekë parashikohet të financohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 5754/1 Prot.

Lushnjë, më 16/06/2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 56 DATË 16/06/2026

" PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: "SISTEMIM ASFALTIM I RRUGËVE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE ALLKAJ, FIERSHEGAN,BALLAGAT, KRUTJE , DUSHK, KARBUNARË"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë , në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja " b ", pika 1.6 shkronja " a ", neni 23 pika 4 të Ligjit nr. 139/2015, " Për vetëqeverisjen vendore ", i ndryshuar. Neni 1 shkronja " b " neni 4 pika 1 neni 12 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit " i përditësuar . Neni 4 pika 4, neni 6 shkronja " b ", neni 7 pika 1 të Ligjit nr. 68/2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " Ju:

PROPOZOJMË

1. Miratimin e investimit me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugëve në Njësitë Administrative Allkaj, Fiershegan, Ballagat, Krutje, Dushk, Karbunarë", bashkëngjitur projekti dhe preventivi.
2. Miratimin e vlerës totale të investimit në shumën 170,710,340.28 lek nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike dhe Prokurorimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE Bedri Hida

DREJTORIA E FINANCËS Ervisa Çuko P/ Ornela Dosti

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com